

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM NR. 360, DATË 29.4.2015 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E TYRE””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është:

- (i) unifikimi i terminologjisë së përdorur në VKM 360/2015 me termat sipas Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;
- (ii) rishikimi dhe përditësimi i Anekseve që shoqërojnë VKM nr. 360/2015, me Anekset e rinj të propozuar sipas këtij vendimi;

Objektivi i këtij projektvendimi është harmonizimi i legjislacionit ekzistues kombëtar (VKM 360/2015) me atë të Bashkimit Evropian, për fushën e kimikateve dhe specifikisht për ndotësit organik të qëndrueshëm.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është hartuar në përputhje me programin e Qeverisë Shqiptare, ku përcaktohet objektivi për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe garantohet mbrojtja e shëndetit dhe mjedisit nga përdorimi i substancave me rrezikshmëri të lartë.

Ky projektvendim është planifikuar në planin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2022, katërmujori II, si dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), për vitin 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre””

Në zbatim të nenit 37, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, në vitin 2015, u miratua VKM nr. 360, datë 29.4.2015 "Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre". Ky vendim ka si qëllim të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të qëndrueshëm (NOQ), bazuar në parimin e parandalimit, nëpërmjet:

- a) ndalimit, nxjerrjes nga përdorimi të NOQ-ve ose kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit sipas përcaktimeve të dhëna në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) reduktimit të shkarkimeve në mjedis të NOQ-ve deri në eliminimin e tyre;
- c) menaxhimit të mbetjeve që kanë në përbërjen e tyre ose që janë të ndotura me NOQ.

VKM 360/2015, ka transpozuar legjislacionin e BE-së në fuqi në atë periudhë, Rregulloren nr. 850/2004/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, "Për ndotësit organikë të qëndrueshëm", datë 29 prill 2004, e amenduar. Legjislacioni i BE-së në këtë fushë ka pësuar ndryshime dhe prej korrikut 2019, është në fuqi dhe zbatohet Rregullorja e re (EU) 2019/1021 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 20 qershor 2019, mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm (recast).

Risitë që sjell Rregullorja 2019/1021, të cilat konsiderohen relevante për tu transpozuar në vendin tonë, lidhen me: (i) unifikimi i termave teknik në përmbajtjen e saj me termat që përdoren në një nga Rregulloret kyçe të BE-së 1907/2006 (REACH), e përafëruar në legjislacionin tonë nëpërmjet Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; (ii) përditësimi i Anekseve bashkëlidhur saj.

Sa më sipër dhe duke vlersuar rendësinë e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, MTM ndërmori nismën për përditësimin e VKM-së 360/2015, në përputhje me Rregulloren 2019/1021.

Ashtu si dhe Rregullorja e BE-së 2019/1021, edhe projektvendimi që propozohet, synon:

(i) Unifikimin e termave teknik që përdoren zbatim të saj me termat që përdoren sipas Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve";

(ii) përditësimi i Anekseve të VKM-së 360/2015 me Anekset e rinj të propozuar bashkëlidhur.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 360, datë 29.4.2015 "Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre"

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

VKM 360/2015, është miratuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Projektvendimi i ri dhe ndryshimet që propozohen, janë në harmoni me legjislacionin aktual të BE-së, në këtë fushë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE-së* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi, synon të transpozojë pjesërisht Rregulloren (EU) 2019/1021 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 20 qershor 2019, mbi ndotësit organik të qëndrueshëm (recast), OJL 169 25.6.2019, fq. 45; CELEX: 02019R1021.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi ka në përmbajtjen e tij 3 pika, të cilat propozojnë që në VKM 360/2015, të bëhen ndryshimet si vijon:

Pika 1, propozon ndryshimin e përmbajtjes së katër përkufizimeve dhe shtimin e gjashtë përkufizimeve të reja që përdoren në zbatim të VKM-së 360/2015, me qëllim unifikimin e terminologjisë me termat e përdorur në Ligjin 27/2016;

Pika 2, propozon përditësimin e Anekseve ekzistuese I-IV, të përcaktuara në shkronjat „a“ deri në „ç“, të pikës 3, të kreut I, VKM-së 360/2015, me 4 Anekset e rinj që i bashkëlidhen këtij projektvendimi;

Pika 3, synon përditësimin e emërtimeve të institucioneve përgjegjëse për mjedisin me emërtimet aktuale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, janë të njëjtat institucione të parashikuara në VKM 360/2015. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe institucionet përgjegjëse të linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”

Projektvendimi, propozohet të hyjë në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 Dhjetor 2022. Kjo periudhë tranzitore do ti japë mundësi subjekteve dhe institucioneve të interesuara për tu njohur me parashikimet e këtij vendimi dhe të sigurojnë zbatimin e tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në konsulencë me ekspertët e Agjencisë Suedeze të Kimikateve (KEMI), në kuadër të Projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”.


Projektvendimi, do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme.

Me qëllim njohjen dhe familjarizimin e grupeve të interesit, ekspertëve të fushës dhe qytetarët, me këtë projektvendim, projektakti do të publikohet edhe në faqen zyrtare të konsultimit me publikun.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektvendimi nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI



Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”